



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:236357

Datë: 30.12.2022

Numri i dokumentit: 03820087

PKR. Nr. 228/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Krimeve të Rënda, me Kryetarin e trupit gjykues, gjyqtarin Murat Hulaj, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Alan Taranish, në çështjen penale kundër të akuzuarit V.M. nga fsh. K., K. Pejë, për shkak të veprave penale, **“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par.1, dhe veprës penale **“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”** nga neni 367 par. 2, të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, **PP/I Nr. 296/2022 dt. 17.11.2022**, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar me datë **22.12.2022**, në prezencë të Prokurorit të shtetit Ersan Qavolli, të akuzuarit V.M., si dhe mbrojtëses së tij av. Majlinda Kollçaku e angazhuar sipas detyrës zyrtare, te njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. **30. 12.2022**, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

V.M., i biri i R. dhe i H., e gjinisë D., i lindur me dt. ... në P., me vendbanim në fshatin K., K. e Pejës , Rruga ..pa numër, i martuar, baba i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr. personal, me nr. telefoni-///-..., Shqiptar, Shtetas i R. së Kosovës, **mbrohet në liri**,

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I. Më parë e gjerë me dt.23.10.2022 në mënyrë të paautorizuar dhe në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit mbi armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe posedim një pushkë automatike ..-. me numër serik cal.7.62x39 m.m, me numër serik së bashku me një karikator dhe 6 fishekë të cal.7.62x39 m.m., e cila armë dhe municion janë sekuestruar nga i pandehuri në shtëpinë e tij nga ana e hetueseve policorë e të cilët kishin shkuar në shtëpinë e të pandehurit pasi nga familjarët e tije në Polici ishte lajmëruar një rast i dhunës familjare,

- me çka ka kryer veprën penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”**, nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

II. Me dt.23.10.2022 rreth orës 05:00 minuta në fshatin C., K. e D. para dyerve të oborrit të shtëpisë së dhëndrit të tije B. B. duke vepruar në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit mbi armë (Ligji Nr.05/L-022) ka përdorur në mënyrë kërcënuese dhe frikësuese armën e lartcekur, pushkën automatike ... me numër serik cal.7.62x39 m.m, me numër serik ashtu që pasi më parë kishte pasur mosmarrëveshje me nënën e tije në fshatin K. nga shtëpia e tije shkon në oborrin e dhëndrit të tij B. në fshatin C. ku edhe shtënë njëherë në ajër duke shkaktuar frikë dhe pasiguri tek familja e dhëndrit të tije B. B. e të cilën armë së bashku me një karikator dhe pesë fishekë i pandehuri ia dorëzon hetuesve policor pasi shkojnë në shtëpinë e tij në mënyrë vullnetare,

- me çka ka kryer veprën penale **“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”**, nga neni 367 par. 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 8 par. 1, 9, 10 par. 1, 17 par. 1, 21 par. 1 dhe 2, 38, 39, par. 1 nën par. 1.1, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 71, 72, 76, dhe 366 par. 1 dhe par. 3 dhe 367 par. 2 të KPRK-së, dhe nenit 245, 246, 248 par. 1 dhe 4, 282 par. 2 nën par. 2.1, 359, 360, 361, 365, 366, 450 par. 1 dhe 2, të KPPRK-së, të pandehurit V.M. i:

P ë r c a k t o n

- Për veprën penale nga dispozitivi **I**, të këtij aktgjykimi dënim me gjobë në shumë prej gjashtëqind (600) euro.
- Për veprën penale nga dispozitivi **II**, të këtij aktgjykimi dënim me gjobë në shume prej dyqind (200) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve, ku dënimi me burgim me pëlqimin e tij, i është zëvendësuar me dënim me gjobë, në shumë prej gjashtëqind (600) euro,

Ne kuptim te nenit 76 par.1dhe par.2 nën par 2.4 te KPRK-së, gjykata te pandehurin V.M. e:

G J Y K O N

- I. Me dënim unik me gjobe në shumë prej 1.400 (një mije e katërqind) euro, e të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaje në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në dy këste të barabarta, duke filluar nga data 01 e deri me datën 05 të çdo muaji vijues.
- II. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse i akuzuari nuk e paguan këstin me kohe.
- III. Nëse i pandehuri, refuzon, dështon apo nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë si në piken II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i njëjti do të zëvendësohet ne dënim burgimi duke i llogaritur shumen prej 20 (njëzetë) euro për një ditë burgimi.
- IV. I pandehuri obligohet që gjykatës ti paguan shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor ne shumë prej tridhjetë (30) euro, dhe shumën prej pesëdhjetë

(50) euro ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pasi që ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm.

- V. Në kuptim të nenit 366 par. 3 të KPRK-së e lidhur me nenin 282 par. 2 nën par. 2.1 të KPPRK-së, të pandehurit V.M. i shqiptohet:

DËNIMI PLOTËSUES – MARRJA E SENDIT/KONFISKIMI

KONFISKOHET një (1) pushkë automatike ... me numër serik, cal. 7.62x39 mm si dhe një (1) karikator dhe gjashtë (6) fishekë të cal. 7.62x39mm, dhe te njëjtat **URDHËROHEN**, të shkatërrohen pasi qe Aktgjykimi të behët i plotfuqishëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën nën shenjen **PP/I Nr. 296/2022 dt. 17.11.2022** kundër të akuzuarit V.M. nga fsh. K., K. Pejë, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”** nga neni 366 par.1 dhe veprës penale nga neni **“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”** nga neni 367 par. 2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 22.12.2022, në të cilën kane qenë të pranishëm Prokurori i Shtetit nga Prokuroria Themelore në Pejë Ersan Qavolli i pandehuri V.M., si dhe mbrojtësja e tij av. Majlinda Kollçaku, e angazhuar sipas detyrës zyrtare.

Pas njoftimit të të pandehurit lidhur me të drejtat e tij nga neni 246 par. 1 të KPPRK-së, i njëjti ka deklaruar se e ka kuptuar të drejtat e tij dhe se për mbrojtës e pranon av. Majlinda Kollçaku e cila i është caktuar sipas detyrës zyrtare, me të është konsultuar paraprakisht dhe nuk ka nevojë për konsultë shtesë.

Pas konstatimit të aktakuzës nën shenjen **PP/I Nr. 296/2022 dt. 17.11.2022** si e lexuar, në seancën e shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, të pandehurit V.M. dhe mbrojtëses së tij av. Majlinda Kollçaku, gjykata është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për fajësinë apo pafajësinë.

Në këtë rast gjykata, ka udhëzuar të akuzuarin, për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë, dhe i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e pranon fajësinë për veprat penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”** nga neni 366 par.1 dhe veprën penale **“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”** nga neni 367 par. 2 të KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim, i vjen keq për veprimin e bërë.

Prokurori i Shtetit në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit V.M., ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë, meqenëse ka mbështetje në shkresat e lëndës, dhe i propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë ta aprovon.*

Mbrojtësja e të pandehurit, av. Majlinda Kollçaku, në lidhje me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit V.M., ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim*

pasi që ky pranim i fajësisë është shprehja e vullnetit të tij të lire pas konsultimeve me mua si mbrojtëse, dhe pasi që i janë shpjeguar kushtet, privilegjet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, dhe i propozoj gjykatës që këtë pranim të fajësisë të aprovon.

Në vijim, gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata me Aktvendim procedural, e ka aprovuar pranimin e fajësisë, për veprat që i vihen në barrë, nga ana e të akuzuarit ngase pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat vijuese: *Raporti i Policit K. Z. dt.22.10.2022, Raporti Informues i policit E. S. dt.23.10.2022, Raporti Informues i policit A. K. i dt.23.10.2022, dy deklaratat e të dëmtuarës H. M e dhënë në Polici me dt.22.10.2022 dhe deklarata e të pandehurit V.M. e dhënë në Polici me dt.23.20.2022 dhe me dt.16.11.2022 në prokurori, konfirmimi i urdhërit gojor për bastisje nga Gjykata Themelore në Pejë nën UGJK.nr. 158/22 i dt. 24.10.2022, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes nga hetuesit e krim-teknikës, fotoalbumi nga Njësia e Forenzikës, foto të armës së sekuestruar si dhe shkresat tjera të lëndës, dhe mbi këtë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë, se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe për këtë është vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par. 1 pika 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushte nga neni 326 par. 4 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje penale nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata pas deklarimit të pandehurit se e pranon fajësinë në kuptim të nenit 248 par. 4, të KPPRK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.*

Prokurori i Shtetit në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *konform nenit 70 par. 3 të KPRK-së i propozoj gjykatës që pranimi i fajësisë të merret si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit, ndërsa konform par. 2 të këtij neni të merren si rrethana rëndësuese mënyra e kryerjes së veprës penale dhe lidhja familjare në mes të pandehurit dhe të viktimës.*

Mbrojtësja e të pandehurit, av. Majlinda Kollçaku në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *sa i përket rrethanave i propozoj gjykatës dhe e njoftoj njëkohësisht që i mbrojturi im ditën kritike i cili ka shkuar tek dhëndri i tij tani janë pajtuar dhe nuk kane më mosmarrëveshje andaj edhe kjo rrethane propozoj që të merret si rrethane lehtësuese me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.*

I pandehuri V.M. në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rëndësuese ka deklaruar se: *me vjen keq që ka ndodhur, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do ta përsëris veprimet e tilla, ne jemi pajtuar mes veti, ka qenë një mosmarrëveshje e vogël.*

Me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale **“Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve”** nga neni 366 par.1 dhe veprën penale **“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”** nga neni 367 par. 2 të KPRK-së

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprat penale për të cilat është akuzuar ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Kryetari i trupit gjykues në aplikim të neneve 69 dhe nenit 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të përcaktuara e të përmendura edhe nga ana e Prokurorit të Shtetit gjatë seancës të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethana lehtësuese gjeti se i pandehuri ka pranuar fajësinë në mënyrë të vullnetshme, po ashtu pendimin e tij për veprën e kryer, pajtimin e tij me të dëmtuarin dhe familjen e tij, sjelljen e tij korrekte gjatë shqyrtimit, mosdenueshmerine e tij, të mëparshme, ndërkaq nga rrethanat rënduese gjykata në rastin konkret për të pandehurin e lartcekur, për veprën e parë penale nuk gjeti asgjë, ndërsa në raport me dispozitivin II të këtij aktgjykimi, gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale, pasi që i njëjti ka përdorur armen në mënyrë kërcënuese në ora 05:00 të mëngjesit dhe atë para shtëpisë së dhëndrit të tij, ndërsa si rrethane tjetër rënduese ka gjetur lidhjen familjare mes të pandehurit dhe të dëmtuarit, pasi që i pandehuri të dëmtuarin e ka dhëndër.

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit për veprën penale, **“Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm”**, nga neni 367 par. 2 të KPRK-së, ka aplikuar dispozitat të cilat kanë të bëjnë me zbutjen e dënimit, e krejt kjo duke pasur parasysh rrethanat veçanërisht lehtësuese të cekura si më lartë, ashtu që duke vepruar konform dispozitave ligjore të nenit 71 dhe 72 par. 1, nën par. 1.5 të KPRK-së, e ku përcaktohet se, *“nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim”* ashtu që gjykata të njëjtit i ka shqiptuar dënimin me burgim ndër minimumit të parapare ligjor në aplikim të këtyre dispozitave.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me gjobë për veprën penale “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së u morr konform nenit 43 par. 1 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e dënimit me gjobë dhe me burgim për veprën penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 2 të KPRK-së u morr konform nenit 42 dhe 43 të KPRK-së.

Vendimi për zëvendësimin e dënimit të shqiptuar me burgim në dënim me gjobë u morr konform nenit 44 par. 1 dhe 2 të KPRK-së pasi që i pandehuri pas shpalljes se aktgjykimit ka dhënë pëlqim për një gjë të tillë.

Vendimi për shqiptimin e dënimit unik me gjobë u morr konform nenit 76 par. 1 dhe 2 pika 2.4 të KPRK-së.

Konform nenit 43 par. 2 të KPRK-së, gjykata ka marrë vendim që dënimin e unifikuar me gjobë në shume prej një mije e katërqind (1400) euro të paguaje në dy këste të barabarta duke filluar nga data 01 e deri me datën 05 të çdo muaji vijues. Po ashtu, konform të njëjtës dispozite, mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse i njëjti nuk e paguan këstin me kohe.

Vendimi për zëvendësimin eventual e dënimit të shqiptuar me gjobe me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon apo refuzon ta paguan dënimin me gjobë u morr konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, u morr në bazë të nenit 453 par.1 lidhur me nenin 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi për taksat e kompensimit të viktimave të krimit, u morr në bazë të qarkores për zbatimin e ligjit NR.05/L-36.

Vendimi për konfiskimin të armës dhe municionit, u morr konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së e lidhur me nenin 282 par. 2 nën par. 2.1 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.228/22 dt. 30.12.2022

Zyrtari ligjor,
Alan Taranish

Kryetari i trupit gjykues,
Dr.sc. Murat Hulaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.